

VENDIM
Nr.44, datë 27.1.2006

PËR SHMANGIEN E NEPOTIZMIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2 të nenit 3 të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndalohej të ushtrojnë detyrën brenda një institucionit publik punonjës të lidhur mes tyre me lidhje familjare, gjinie apo krushqie. Përbën shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës ekzistenca e lidhjeve si më poshtë vijon:

- a) lidhje familjare: bashkëshort/bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre;
- b) lidhje gjinie: prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj;
- c) lidhje krushqie: prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es, si dhe bashkëshort/bashkëjetuesi i fëmijëve.

“Bashkëjetues, sipas shkronjave “a” e “c” të kësaj pike, është personi i cili cilësohet i tillë sipas nenit 163 të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i familjes”.

2. Personat e përzgjedhur, fitues nga konkurrimi, para fillimit të marrëdhënies së punës në institucion, deklarojnë me shkrim, sipas formularit bashkëlidhur, lidhjet familjare, të gjinisë a të krushqisë me persona të tjerë në institucion. Kur konkurrenti fitues ka lidhje me rrethin e personave të përfshirë në pikën 1 të këtij vendimi, skualifikohet si i papajtueshëm për kryerjen e detyrës.

3. Personat e punësuar në institucionin publik kanë për detyrë të rideklojnë lidhjet familjare, të gjinisë a të krushqisë, të krijuara rishtazi në institucion, brenda 2 javësh nga lindja e detyrimit sipas kësaj pike. Titullari i institucionit ka të drejtë të ngarkojë njësinë e personelit të kryejë verifikimin e deklaramëve, kur ka të dhëna të besueshme për paraqitje rrethanash të rreme në to.

4. Në mungesë të një kërkesë me shkrim nga personat e lidhur mes tyre me lidhje familjare, gjinie a krushqie, titullari i institucionit përcakton brenda 2 javësh nga dita e depozitimit të formularit, se cili nga personat e lidhur do të qëndrojë në detyrë.

5. Deklarimi i parë i lidhjeve familjare, të gjinisë dhe të krushqisë në institucionet publike të kryhet brenda 6 javësh kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ekzistenca e lidhjeve familjare në institucion përbën shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me njërin nga personat e lidhur mes tyre.

6. Punonjësit e skualifikuar sipas këtij vendimi trajtohen si më poshtë vijon:

a) Vendosen në listë pritjeje dhe trajtohen sipas dispozitave ligjore në fuqi, kur gëzojnë statusin e nëpunësit, në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

b) Përfitojnë, kur kanë mbi 3 vjet vjetërsi pune të vazhdueshme në institucion, shpërblim financiar të menjëhershëm, të barabartë me pagën e 15-ditëshit, për çdo vit pune të plotë, që llogaritet në bazë të pagës që ka në përfundim të marrëdhënieve të punës, kur janë të punësuar sipas ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

7. Ky vendim e shtrin fushën e vet të veprimit në të gjitha organet e administratës publike, ku personeli trajtohet sipas ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe në të gjitha institucionet e tyre të varësisë, pavarësisht nga pozicioni dhe detyra, me përjashtim:

- a) të personelit të Policisë së Shtetit që rregullohet me ligjin “Për Policinë e Shtetit”;
 - b) të kategorive të caktuara të punonjësve të administratës doganore dhe tatimore, që trajtohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave;
 - c) të personelit mjekësor të shërbimit spitalor, përjashtuar punonjësi i nivelit drejtues.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Në mbështetje të ligjit nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare”, ky dokument është i hapur për publikun. Unë deklaroj jam në dijeni të detyrimit për rideklarim rishtazi, sipas pikës 3, të lidhjeve familjare, të gjinisë a të krushqisë, me rrethin e personave të caktuar në vendimin nr.44, datë 27.1.2003. të Këshillit të Ministrave, sapo të ndryshojë ndonjë rrethanë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(Emri i institucionit)

Formular deklarimi:

Deklaruesi: _____

Pozicioni: _____

Vendi i punës: (Drejtoria/Sektori) _____

Lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë në institucion

Në mbështetje të vendimit nr.44, datë 27.1.2006 të Këshillit të Ministrave “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike”,

Unë nënshkruesi _____

(emër,atësia,mbiemër)

kandidat/i punësuar pranë këtij institucioni, më datë ____/____/200

(data,muaji,viti)

nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se

_____lidhje familjare, të gjinisë a të krushqisë, si ato të përcaktuara në pikën 1 të vendimit, me persona punonjës deri titullar i këtij institucioni _____

Kjo deklaratë është hartuar me të
dhënat në ditën e deklarimit

_____/_____/200

Nënshkruesi _____

DEKLARATA PLOTËSISHT NGA DEKLARUESI ME SHKRIM DORE.